

KËSHILLI NDËRKOMBËTAR I ARKIVAVE  
INTERNATIONAL COUNCIL ON ARCHIVES  
CONSEIL INTERNATIONAL DES ARCHIVES



ISAAR (CPF)  
STANDARDI NDËRKOMBËTAR PËR  
DOKUMENTE ARKIVORE TË NORMUARA PËR  
PERSONA JURIDIKË E FIZIKË  
DHE FAMILJE

**(Botimi i dytë)**

Përgatiti dhe përshtati: Dr. Jusuf Osmani

Prishtinë, 2009

---

Titulli i origjinalit

***ISAAR (CPF) INTERNATIONAL STANDARD  
ARCHIVAL AUTHORITY RECORD FOR CORPORATE  
BODIES, PERSONS AND FAMILIES***

**Botues: Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës**

E ka përgatitur Komiteti për përshkrimet e standardeve të Këshillit Ndërkombëtar të Arkivave në Canberri (Australi), 27-30 tetor 2003.

Dedikuar:

- *Hugu Leendertu Philipu Stibbeu*, sekretar i projektit dhe drejtor,
- Ad Hoc Komiteti ndërkombëtar për përshkrime të standardeve (1990-1996) dhe Komiteti për përshkrime të standardeve të Këshillit Ndërkombëtar të Arkivave (1996-2000)  
dhe
- *Kentu Haworthu*, anëtar i Komitetit për përshkrime të standardeve të Këshillit Ndërkombëtar të Arkivave (1996-2000)
- Sekretarit dhe Projekt-drejtorit të Komitetit për përshkrime të standardeve të Këshillit Ndërkombëtar të Arkivave (2000-2002)

Përktheu nga gjuha kroate dhe përshtati me shembuj dhe terma në gjuhën shqipe: dr. Jusuf Osmani

Përkthimi dhe shtypja e standardit është jokomercial, për qëllime referale në pajtim me lejën e Këshillit Ndërkombëtar të Arkivave.

Është përkthyer dhe botuar me pelqimin e Këshillit Ndërkombëtar të Arkivave.

Në përgjegjje të kërkesës për botim thuhet:

*"Dear Mr Osmani,*

*Thank you very happy that the State Agency of Kosovo Archives will promote these publication in Kosovo.."*

*"I nderuari z. Osmani,*

*Ju falënderojmë shumë. Ne jemi shumë të kënaqur që Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës do t'i publikojë këto publikime në Kosovë...."*

*Paris, mars 2009.*

## PËRMBAJTJA

<b>PARATHËNIE E BOTUESIT .....</b>	<b>5</b>
<b>PARATHËNIE.....</b>	<b>7</b>
<b>1. QËLLIMI DHE NIVELI.....</b>	<b>10</b>
<b>2. STANDARDI I NDËRLIDHUR DHE UDHËZIMET .....</b>	<b>12</b>
<b>3. FJALOR I TERMAVE DHE DEFINICIONEVE.....</b>	<b>15</b>
<b>4. STRUKTURA DHE APLIKIMI I STANDARDIT .....</b>	<b>16</b>
<b>5. ELEMENTET E DOKUMENTIT TË NORMUAR</b>	
<b>5.1. LËMIA: IDENTITETI .....</b>	<b>19</b>
5.1.1. Lloji i krijuesve (entiteteve) .....	19
5.1.2. Forma(t) zyrtare të emrave/titujve.....	18
5.1.3. Format paralele të emrave/titujve .....	21
5.1.4. Format e standardizuara të emrave/titujve në pajtim me rregullat tjera.....	22
5.1.5. Format tjera të emrit/titullit .....	22
5.1.6. Identifikatorët për personat juridik.....	24
<b>5.2. LËMIA E PËRSHKRIMIT .....</b>	<b>24</b>
5.2.1. Koha e veprimit.....	25
5.2.2. Historiku.....	26
5.2.3. Vendi.....	27
5.2.4. Statusi juridik .....	28
5.2.5. Funkcioni, profesioni dhe veprimtaria.....	29
5.2.6. Kompetenca(t)/burimet e autorizimet .....	30
5.2.7. Rregullimi brendshëm/gjenealogjia .....	32
5.2.8. Konteksti i përgjithshëm.....	34
<b>5.3. LËMIA: MARRËDHËNIET/LIDHJET.....</b>	<b>35</b>
5.3.1. Emri(at)/Shenja(t) të personave juridik të ndërlidhur, fizik ose familjeve .....	36

5.3.2. Llojet e marrëdhënieve/lidhjeve.....	36
5.3.3. Përshkrimi i marrëdhënieve/lidhjeve .....	37
5.3.4. Datat e marrëdhënieve/lidhjeve.....	37

#### **5.4. LËMIA: KONTROLLI**

5.4.1. Identifikatori (Shenja) e dokumentit të normuar .....	42
5.4.2. Identifikatorët (Shenjat) e institucionit.....	43
5.4.3. Dispozitat dhe/ose rregullat .....	44
5.4.4. Statusi.....	45
5.4.5. Niveli i detajeve .....	45
5.4.6. Data(t) e përpilimit, ndryshimit ose fshirjeve .....	46
5.4.7. Gjuha(ët) dhe shkrimi(et).....	47
5.4.8. Burimet .....	47
5.4.9. Vërejtjet për ruajtje .....	48

#### **6. NDËRLIDHJET E PERSONAVE JURIDIK, FIZIK DHE FAMILJEVE ME LËNDËN ARKIVORE DHE BURIMET TJERA .....**

6.1. Identifikatorët dhe emrat/titujt e burimeve të ndërlidhura .....	49
6.2. Llojet e burimeve të ndërlidhura .....	49
6.3. Natyra e lidhjeve/marrëdhënieve.....	50
6.4. Datat e burimeve të ndërlidhura dhe/ose lidhjet/marrëdhëniet.....	50

#### **SHTOJCA A**

- Elemente të krahasimit ( <i>Mapping</i> ) të përshkrimit ndërmjet botimit të parë dhe të dytë të ISAAR (CPF) .....	54
--	----

#### **SHTOJCA B**

Shembull 1 - Përshkrimi i personit fizik.	
Gjuha shqipe: (Republika e Kosovës) .....	55
Shembulli 2 - Përshkrimi i personit juridik.	
Gjuha shqipe: (Republika e Kosovës) .....	60
Shembulli 3 - Përshkrimi i personit juridik.	
Gjuha: angleze (Shetetet e Bashkuara të Amerikës).....	64
Shembulli 4 - Përshkrimi i personave fizik.	
Gjuha: angleze (SHBA) .....	67
Shembulli 5 - Përshkrimi i familjeve	
Gjuha: angleze (Britania e Madhe) .....	71

## **PARATHËNIE E BOTUESIT**

Një prej detyrave themelore të zhvillimit të shërbimit arkivor të Kosovës është edhe zbatimi dhe aplikimi i standardeve ndërkombëtare të arkivistikës. Standardi ISAAR (CPF) për dokumentet arkivore të normuara për persona juridik dhe fizik si dhe familjet përkthehet dhe përshtatet në gjuhën shqipe me qëllim që arkivistët nga Kosova të njihen me format më të reja të punës profesionale në arkiva dhe që dispozitat ligjore kombëtare, rregullat, udhëzimet etj. të arkivistikës të jenë sa më bashkëkohore. Këtu na obligon edhe pranimi i arkivave të Kosovës në Këshillin Ndërkombëtar të Arkivave, si arkiv nacional, në kategorinë A.

Këtë standard e ka aprovuar Komiteti për përshkrime arkivore të Këshillit Ndërkombëtar të Arkivave (ICA) në Kambera të Australisë në tetor të vitit 2003, ndërsa është aprovuar dhe publikuar në Kongresin e KNA të mbajtur në vitin 2004 në Vjenë të Austrisë.

Gjatë përkthimit të tekstit të marrë në internet nga gjuha boshnjake, jemi munduar që të jetë sa më autentik dhe të përshtatet terminologjisë dhe përvojave të deritanishme vendore.

Në Shtojcë B, Shembujt e theksuar, si ilustrim e kemi marrë vetëm tekstin në gjuhën angleze të përvojave kanadeze, ndërsa në standard ekzistojnë edhe shembuj nga Shtetet e Bashkara të Amerikës, Australisë, Britanisë së Madhe, Italisë, Gjermanisë dhe Francës.

ISAAR (CPF) si dhe ISAD(G) aplikohet në shumë shtete pa marrë parasysh në dallimet në legjislacionin kombëtar. Për dallim nga ISAD(G) i cili me elementet e tija është i njohur me teorinë dhe praktikën tonë, ISAAR(CPF) më tepër është i përafërt me standardet e bibliotekës.

Këto standarde janë krijuar si rrjedhojë e zhvillimit të teorisë dhe praktikës arkivore në botë.

Gjatë zbatimit të Standarit Ndërkombëtar të dokumentit të normuar arkivor për personat fizik e juridik dhe familjet ISAAR (CPF) i kemi zbatuar udhëzimet, të cilat në këtë aspekt i jep Këshilli Ndërkombëtar i Arkivave në Paris.

Ky botim i standarit ISAAR (CPF) në masë të dukshme është zgjëruar nga ajo e para e vitit 1996. Botimi i versionit të parë në gjuhën shqipe është bërë në vitin 2002, ndërsa, versionin e dytë po e botojnë në këtë rast.

Dr. Jusuf Osmani

## PARATHËNIE

- P1.** Botimin e parë të këtij standardi e ka punuar Komiteti Ad Hoc për standarde të përshkrimeve të Këshillit Ndërkombëtar të Arkivave (ICA/DDS) në periudhën prej vitit 1993 deri më 1995. Standardin e ka publikuar Këshilli Ndërkombëtar i Arkivave (KNA) në vitin 1996. Komiteti është bërë këshill i përhershëm INA në Kongresin ndërkombëtar në Peking (Kinë) në vitin 1996. Komiteti i tanishëm për standarde të përshkrimeve (ICA/CDS) e ka marrë revizionin e standarit ISAAR (CPF) si detyrë parësore në programin e punës së vet në periudhën katërvjeçare prej vitit 2000 deri më 2004.
- P2.** Ky, botim i dytë ISAAR (CPF) është rezultat i procesit pesëvjeçar të revizionit me të cilin është pajtuar Komiteti për standarde i Këshillit Ndërkombëtar të Arkivave. Dërgimi i standardit bashkësisë ndërkombëtare me qëllim të dhënies së propozimeve për revizion është bërë në fund të vitit 2000, nëpërmjet të letrave të dërguara të gjithë anëtarëve institucional të KNA, disa njësisive organizative në kuadër të KNA, si dhe institucioneve të përafërta ndërkombëtare. Standardi gjithashtu është dërguar nëpërmjet të postës elektronike Regjistrin MAV [ICA List] dhe listave të tjera e-mail relevante diskutuese. Si afat i fundit për dërgimin e vërejtjeve është caktuar 31 korriku 2001, në mënyrë që për revizion të mund të diskutohej në mbledhjen plenare të Komitetit në Brukselë, prej 3 deri më 6 tetor 2001.
- P3.** Deri në gusht 2001, Sekretariati i Komitetit ka pranuar 18 dërgesa nga këshillat nacional, organizatat dhe individët. Vërejtjet janë grumbulluar në material, i cili iu është dërguar të gjithë anëtarëve të Komitetit para mbledhjes plenuare në Brukselë.
- P4.** Në mbledhjen plenare në Brukselë, Komiteti i ka shqyrtuar vërejtjet e dërguara dhe ka pruar shumë vendime përkitazi të cilat duhet të aplikohen për standard. Në atë vazhde, projekti i parë i ndryshimeve të ISAAR (CPF) është punuar në bazë të vendimeve të pruar në Brukselë. Ky projekt ka shkuar të anëtarët e Komitetit dhe më tutje

është përpunuar në mbledhjet plenare të Komitetit në Madrid, në qershor të vitit 2002 dhe në Rio de Janeiro, në nëntor të vitit 2002. Projekti është botuar në WEB faqën e ICA/CDS në janar të vitit 2003. Në atë kohë bashkësia ndërkombëtare arkivore ka shqyrtuar vërjetjet e propozuara për ndryshime në standard, në afat deri më 15 korrik. Këto vërjetje janë shqyrtuar në mbledhjen plenare të Komitetit në Canberri (Australi) në tetor të vitit 2003, kur verzioni përfundimtar i standardit është aprovuar, dhe pastaj është paraqitur në formë të shtypur në Kongresin Ndërkombëtar të Arkivave në Vjenë, 2004.

- P5.** Ky verizon i dytë i ISAAR (CPF) paraqet verizonin e zgjëruar dhe të strukturuar të verizonit të parë të standartit (1996). Standardi i parë i botuar i vitit 1996 përfshinë tri lëmi: Lëmia e Kontrollit normativ, lëmia e Informatave dhe lëmia e Vërjetjeve. Ky botim përfshinë katër lëmi: Lëmia e Identitetit (sikur lëmia e mëparshme Kontrolli normativ); lëmia e Përshkrimit (e njëjtë me atë të mëparshmen Informatat), Lëmia e Marrëdhënieve/Lidhjeve dhe lëmia e Kontrollit (e njëjtë me lëminë e mëparshme Vërjetje). Këto dy lëmi të fundit në thelb janë shtojca të reja të standartit, edhe pse kanë qenë disa mundësi për dokumentin në Marrëdhënie/lidhje, në elementin 2.3.8. të botimit të vitit 1996. Elementet dhe rregullat në kuadër të katër lëmive të reja janë strukturuar dhe janë përpiluar me qëllim të ndihmesës për të kuptuarit e qartë të konceptit dhe veprimit më të mirë në kontekstet e dokumentimit të lëndës arkivore. Në shtojcë, ky botim përmban kapitullin në të cilin përshkruhet se si dokumenti i normuar arkivor mund të ndërlihet me lëndën arkivore dhe me burime tjera, duke përfshirë edhe përshkrimet arkivore në harmoni me Standardin e përgjithshëm ndërkombëtar për përshkrimin e lëndës arkivore (ISAD (G)). Vërjetjet e pranura nga ana e bashkësisë profesionale gjatë kohës së procesit të ndryshimeve, kanë treguar në nevojën e krijimit të një qartësie dhe administrimi të plotë se sa që ishte e paraparë në botimin e vitit 1996. Komiteti shpreson që ky botim të përfshin çështje më të mëdha praktike dhe konceptuale nga profesionalistët të cilët janë munduar të ndërtojnë sisteme të kontrollit të normimit arkivor në harmoni me ISAAR (CPF). Krahasimi (*mapping*) i elementeve të përshkrimit ndërmjet botimit të parë dhe të dytë janë paraqitur në Shtojcën A.
- Në periudhën katërvjeçare prej vitit 200-2004, në Komitetin për përshkrime të standardeve të Këshillit Ndërkombëtar të Arkivave



gjendeshin edhe ndryshimet e bëra të anëtarëve në standardin ISAAR (CPF):

- Nils Brübach (Gjermani)
- Herman Coppens (Belgjikë)
- Adrian Cunningham (Australi) projekt-drejtori dhe sekretari, 2002 - 2004
- Blanca Desantes Fernández (Spanjë)
- Vitor Manoel Marques da Fonseca (Brazil)
- Michael Fox (SHBA)
- Bruno Galland (Francë)
- Kent Haworth (Kanadë) projek-drejtor dhe sekretar, 2000-2002
- Juan Manuel Herrera (Meksikë), 2002-2003
- Gavan McCarthy (Australi), 2002-
- Per-Gunnar Ottosson (Suedi)
- Lydia Reid (SHBA)
- Dick Sargent (Britani e Madhe)
- Hugo Stibbe (Kanadë) kryetar i përkohëshëm i projektit dhe serketar, qershor 2002
- Yolia Tortolero (Meksikë), 2003-
- Stefano Vitali (Itali) kryesues

Komiteti për standarde të përshkrimeve të KNA iu falëndëron për sponzorim të mbledhjeve plenare këtyre institucioneve:

- Arkivi i Mbretërisë dhe Arkivi Shtetëror, Bruxelles, Belgjikë
- Ministria e kulturës, Sektori për arkiva shtetërore, Spanjë
- Arkivi Nacional, Brazil
- Arkivi Shtetëror Australi
- UNESCO

Pa ndihmesën e tyre, si ajo financiare ashtu edhe me mjete të pajisjeve për përgatitjen e mbledhjeve të ndryshimeve të këtij standardi nuk do të ishte e mundur.

## 1. QËLLIMI DHE VËLLIMI

- 1.1 Ky standard jep udhëzime për përpilimin e dokumentit arkivor të normuar, i cili mundëson përshkrimin e entiteteve (personave juridik, personave fizik dhe të familjeve) të ndërlidhura me krijimin dhe ruajtjen e lëndës arkivore.
- 1.2 Dokumentin e normuar arkivor mund të shfrytëzojnë:
  - a. për përshkrim të personave juridik, fizik ose të familjeve si njësi në sistemin e përshkrimit arkivor;  
dhe/ose
  - b. si kontroll e përpilimit dhe shfrytëzimit e pikë qasjeve në përshkrimet arkivore;
  - c. për dokumentimin e marrëdhënieve/lidhjeve ndërmjet krijuesve të ndryshëm të lëndës arkivore dhe marrëdhënieve/lidhjeve ndërmjet të gjithë krijuesve dhe lëndës të cilën e kanë krijuar dhe/ose burimeve të tjera për ato ose të krijuar nga ato.
- 1.3 Përshkrimi i krijuesve të dokumenteve është aktivitet esencial i arkivistëve, pavarësisht nga ajo se a shprehen përshkrimet në sistemet me dorë ose të automatizuara. Kjo kërkon dokumentim të plotë dhe mirëmbajtje të kontinuar të kontekstit të krijimit të dokumenteve dhe shfrytëzimit, si më të rëndësishmit, të prejardhjes së lëndës dhe të dokumenteve.
- 1.4 Standardi përcjellës i këtij dokumenti, ISAD (G): Standardi i përgjithshëm ndërkombëtar për përshkrimin e lëndës arkivore parasheh, në kuadër të përshkrimit të lëndës arkivore, përfshirjen e informatave kontekstuale në cilin do nivel. ISAD (G) gjithashtu i njeh mundësitë e krijimit dhe mirëmbajtjes së informatave kontekstuale të pavarura, si dhe ndërlidhjen e këtyre informatave dhe kombinimin me elementet tjera informative të shfrytëzuara për përshkrimin e lëndës arkivore dhe të dokumenteve.
- 1.5 Ka shumë arsye pse krijimi dhe mirëmbajtja vetanake e këtij lloji informatave kontekstuale është pjesë përbërse vitale e përshkrimit arkivor. Kjo praktikë mundëson ndërlidhjen e përshkrimit të krijuesit të

dokumenteve dhe informatave kontekstuale me përshkrimin e dokumenteve të njëjta/krijuesve të njëjtë të cilët do të mund të ruheshin më shumë se në një institucion dhe me përshkrimin e burimeve të tjera, siç janë materiali bibliotekar dhe muzeor i cili ka të bëjë me krijuesit përkatës. Këto lidhje e përmirësojnë praktikën në udhëheqjen e dokumenteve dhe lehtësojnë kërkimin e tyre.

- 1.6 Kur një numër i madh i institucioneve ruajnë dokumente nga ndonjë burim, ato mundën më lehtë të ndajnë ose të lidhin informatën kontekstuale me këtë burim, nëse ajo është e mirëmbajtur në mënyrën e standardizuar. Ai standardizim është posaçërisht i dobishëm në aspektin ndërkombëtar, edhe pse ndërlidhja e informatave kontekstuale sigurisht do të kalojnë kufijtë nacional. Karakteri multinacional i ruajtjes së kaluar dhe të tanishme të lëndës arkivore krijon nxitje për standardizimin ndërkombëtar, i cili do të mundëson këmbinin e informatave kontekstuale. Për shembull, procesi siç është kolonizimi, imigracioni dhe tregtia i kanë sjellur karakterit multinacional, ruajtjen e dokumenteve.
- 1.7 Qëllimi i këtij standardi është ndihmesa në këmbimin e dokumenteve arkivore të normuara të përshtatshme dhe vetëshpjeguese të personave juridik, fizik dhe familjeve të cilat krijojnë dokumente. Është paraparë që standardi të shfrytëzohet së bashku me standardet ekzistuese kombëtare ose si bazë për zhvillimin e standardeve nacionale.
- 1.8 Dokumenti arkivor i normuar është i përafërt me dokumentet bibliotekare të normuara dhe që të dy format e dokumentit të normuar duhet të ndihmojnë në krijimin e pikë qasjeve në përshkrim. Emri i krijuesit të njësisë së përshkrimit është njëra prej atyre pikë qasjeve më të rëndësishmet. Pikë qasjet mund të fillojnë në përdorimin e përcaktuesve të cilët llogariten esencial për shpjegimin e identitetit të atij të ashtuquajturit krijues, ashtu që mund të krijojnë dallime precize ndërmjet krijuesve të ndryshëm të cilët kanë emra të njëjtë ose të përafërt.
- 1.9 Dokumentet arkivore të normuara, duhet të mbulojnë një tërësi më të gjërë të kërkesave, se sa që është rasti me dokumentet bibliotekare të normuara. Këto kërkesa plotësuese janë të ndërlidhura me vlerën e informatave të dokumentuara për krijuesit e dokumenteve dhe

kontekstit të krijimit të dokumenteve në sistemet e përshkrimit arkivor. Si të tillë dokumentet arkivore të normuara shkojnë edhe më tutje dhe zakonisht do të përfshijnë më shumë informata se sa dokumenti bibliotekar i normuar.

- 1.10 Qëllimi themelor i këtij standardi është, që të siguron rregulla të përgjithshme për standardizimin e përshkrimit arkivor dhe kontekstit të krijimit të dokumenteve që mundësojnë:
- qasja në lëndën arkivore dhe dokumenteve të bazuar në përshkrimet të kontekstit të krijimit të dokumenteve, që janë të ndëlidhura me përshkrimin, shpesh të dokumenteve fizike të llojllojshme të shpërndara;
  - të kuptuarit e të shfrytëzuar të kontekstit të krijimit dhe të përdorimit të lëndës arkivore dhe të dokumenteve në mënyrë që ata mundën më mirë të interpretojnë rëndësinë dhe domedhënien e tyre;
  - identifikimin preciz të krijuesve të dokumenteve, duke përfshirë edhe përshkrimet e marrëdhënieve/lidhjeve ndërmjet krijuesve të ndryshëm, posaçërisht të dokumentimit të ndryshimeve administrative në kuadër të subjekteve juridike ose ndryshimeve personale të rrethanave të individët dhe të familjet; dhe
  - këmbimi i këtyre përshkrimeve ndërmjet institucioneve, sistemeve dhe/ose rrjetave.
- 1.11 Dokumenti arkivor i normuar i përshtatur këtij standardi gjithashtu mund të shërben edhe për formën e kontrollit të emrave dhe identitetit të personit juridik, personit fizik, të cilët gjenden në fletëqasjen të përcaktuar në njësinë e përshkrimit arkivor.

## 2. STANDARDET E PËRAFËRTA DHE UDHËZIMET

**Vërejtje:** Ky regjistrim përfshinë datat e standardeve relevante, ashtu siç kanë ekzistuar në kohën e përfundimit të botimit të dytë të ISAAR (CPF), në fund të vitit 2003. Lexuesëve të ardhshëm iu rekomandohet që të konsultojnë verzionet e fundit të standardeve:

ISAD (G) - *General International Standard Archival Description*, 2nd ed., Madrid: International Council on Archives, 2000. (Standardi i përgjithshëm ndërkombëtar për përshkrimin e lëndës arkivore)

ISO 639-2 - *Codes for the representation of names of languages, Alpha-3 code*, Geneva: International Standards Organization, 1998. (Kodet për paraqitjen e emrave të gjuhëve)

ISO 690 - *Documentation - Bibliographic references - Content, form and structure*, Geneva: International Standards Organization, 1987. (Dokumentacioni – Udhëzimet bibliografike – Përmbajtja, forma dhe struktura)

ISO 999 - *Information and documentation - Guidelines for the content, organization and presentation of indexes*, Geneva: International Standards Organization, 1996. (Informatat dhe dokumentacioni – Udhëzimet, përmbajtja, organizimi dhe paraqitja e indeksit)

ISO 2788 - *Documentation - Guidelines for the establishment and development of monolingual thesauri*, Geneva: International Standards Organization, 1986. (Dokumentacioni – Udhëzimet për përpilimin dhe zhvillimin e tezaurusit njëgjuhësor)

ISO 3166 - *Codes for the representation of names of countries*, Geneva: International Standards Organization, 1997. (Kodet për paraqitjen e emrave të shteteve)

ISO 5963 - *Documentation - Methods for examining documents, determining their subjects, and selecting indexing terms*, Geneva: International Standards Organization, 1985. (Dokumentacioni – Metodatat për studimin e dokumenteve, përcaktimi i përmbajtjes së tyre dhe përzgjedhja e fjalëve për indeksim).

ISO 5964 - *Documentation - Guidelines for the establishment and development of multilingual thesauri*, Geneva: International Standards Organization, 1985. (Udhëzimet për përpilimin dhe zhvillimin e tezaurusit shumëgjuhësor)

ISO 8601 - *Data elements and interchange formats – Information interchange - Representation of dates and times*, 2nd ed., Geneva: International Standards Organization, 2000. (Elementet e të dhënave)

dhe formatet për këmbinin e informatave – Paraqitja e datave dhe kohës)

ISO 15489 - *Information and documentation - Records management, parts 1 and 2*, Geneva: International Standards Organization, 2001. (Informacioni dhe dokumentacioni – Menaxhimi zyrtar, pjesa 1. dhe 2.)

ISO 15511 - *Information and documentation – International standard identifier for libraries and related organizations*, Geneva: International Standards Organization, 2002. (Informacioni dhe dokumentacioni – Shenja ndërkombëtare e standardizuar për biblioteka dhe organizata të përafërta)

ISO 15924 - *Codes for the representation of names of scripts*, Geneva: International Standards Organization, 2001. (Kodet për paraqitjen e titujve të dorëshkrimeve)

*Guidelines for Authority Records and References* / revised by the International Federation of Library Associations Working Group on GARE revision, 2nd ed., München: K.G. Saur, 2001 (UBCIM Publications New series, vol. 23). (Udhëzimet për dokumentet e normuara dhe udhëzimet).

Mandatoru data elements of internationally shared resource authority records: report of the IFLA UBCIM Working group on Minimal Level Authority Records and ISADN, 1998 <http://www.ifla.org/VI/3/p1996-2/mlar.htm> (known as “MLAR”) - Elementet e obliguara të të dhënave për këmbimin ndërkombëtar të dokumenteve të normuara: Raport i grupit punues të IFLA UBCIM për nivelin minimal të dokumentit të normuar dhe ISADN (International Standard Authority Data Number – Numri ndërkombëtar i standardizuar për të dhënat normative), 1998 <http://www.ifla.org/VI/3/p1996-2/mlar.htm> (i njohur si “MLAR”).

Form and Structure of Corporate Headings: Recommendations of the Working Group on Corporate Headings. Approved by the Standing Committees of the IFLA Section on Cataloguing and the IFLA Section on Official Publications, 1980. (updatet in International Cataloguing and Bibliographic Control in 1992. – Forma dhe struktura e përcaktuesëve të organeve kolektive të Rekomandimit të Grupit punës

për përcaktues të personave juridik. E kanë zgjedhur Komitetet e përhershme të IFLA për katalogizim dhe sektori i IFLA për publikimet zyrtare, 1980.

### **3. FJALORI I TERMAVE DHE DEFINICIONEVE**

Fjalori vijues përbën pjesën integrale të këtij standardi. Termat janë definuar në kontekstet e rregullave.

**Përshkrimi arkivor.** Përpilimi i sakt i njësive përshkruese dhe pjesëve përbërse të saj, duke publikuar, analizuar, organizuar dhe shënuar informatat të cilat shërbejnë në njohjen, përdorimin, gjetjen dhe shpjegimin e lëndës arkivore dhe kontekstit të sistemit i cili e ka krijuar. Ky term gjithashtu shfrytëzohet për përshkrimin e rezultatet e atij veprimi. (*Archival description*)

**Dokumenti i normuar.** Forma zyrtare e titullit/emrit të entitetit të kombinuar me elementet tjera të informatës, e cila e identifikon dhe e përshkruan entitetin e përcaktuar dhe mund të tregoj për dokumentet tjera indetike. (*Authority record*)

**Përcaktuesi.** Informata e dhën elementit të përshkruar në mënyrë që të ndihmon në identifikimin, kuptimin dhe/ose përdorimin e dokumentit të normuar. (*Qualifier*)

**Personi juridik.** Organizata ose grup i personave të cilët janë të identifikuar me emër të veçantë dhe të cilët veprojnë ose mund të veprojnë si tërësi. Gjithashtu, përfshijnë edhe veprimin e pavarur brenda bashkësisë së institucioneve ose familjeve. (*Corporate body*)

**Pika e qasjes.** Emër, kuptim, fjalë çelësi, frazë ose çdo gjë që mund të përdoret për kërkim, identifikim dhe gjetje të përshkrimit arkivor, duke përfshirë edhe dokumentin e normuar. (*Access point*)

**Provenienca/përkatësia.** Lidhjet ndërmjet dokumenteve dhe organizatave ose individëve të cilët i kanë krijuar, grumbulluar dhe/ose ruajtur dhe shfrytëzuar për kryerjen e aktivitetit personal ose institucional (*Provenance*).

**Krijuesi i lëndës arkivore.** Çdo entitet (person juridik, familje ose person fizik) i cili ka krijuar, grumbulluar dhe/ose ka ruajtur dokumente me qëllim të kryerjes së aktiviteteve personale ose institucionale. (*Creator*).

**Dokument/shënim.** Informatë në çfardo forme ose bartësi të dhënave, të cilin ndonjë organizatë ose person gjatë kryerjes së veprimtarisë afariste ose aktiviteteve personale, e ka krijuar ose e ka pranuar dhe për të kujdeset. (*Record*)

#### **4. STRUKTURA DHE APLIKIMI I STANDARDIT**

- 4.1 Ky standard përcakton llojin e informatave të cilat mund të përfshihen në dokumentin arkivor të normuar dhe jep udhëzime se si ai dokument mund të vendoset në sistemin e përshkrimit arkivor. Përmbajtja e elementeve të informatave të përfshira në dokumentin e normuar do të jetë e përcaktuar me dispozitat dhe/ose rregullat të cilat institucioni i aplikon.
- 4.2 Ky standard përbëhet prej elementeve të informatave, që secili përmban:
  - a. emrin/titullin e elementit të përshkrimit
  - b. dëshminë e qëllimit të përshkrimit të elementeve
  - c. dëshmia e rregullave të aplikuara në element, dhe
  - d. ku është e mundur, shembujt të cilët e ilustronë aplikimin e rregullave.
- 4.3 Sektorët janë të numëruar dhe janë dhënë vetëm për nevoja të citimit. Këto numra nuk duhej shfrytëzuar në mënyrë që më parë të përcaktohen elementet e përshkrimit ose të përcaktojnë rendin ose strukturën e mjeteve të përshkruara.
- 4.4 Elementet e përshkrimit për dokumentin arkivor të normuar janë të organizuar në katër lëmi:
  1. Lëmia e identitetit  
(ku informata në mënyrë të njëjtë i identifikon krijuesit, të cilët e përshkruajnë dhe e cila i definojnë pikëqasjet e dokumenteve të standardizuara).
  2. Lëmia e përshkrimit  
(ku informata relevante ka të bëjë për natyrën, kontekstin dhe veprimtarinë e krijuesit, i cili e përshkruan)



3. Lëmia e marrëdhënieve/lidhjeve  
(ku janë të shënuara dhe të përshkruara marrëdhëniet/lidhjet me personat fizik dhe juridik dhe/ose familjet)
4. Lëmia e kontrollit  
(ku dokumenti i normuar është indentifikuar në mënyrë unike dhe është dhënë informata si është, kur dhe cili institucion e ka punuar dhe e ka ruajtur dokumentin e normuar).
- 4.5 Ky standard, gjithashtu, në kapitullin 6 i jep udhëzimet për lidhje të dokumentit të normuar arkivor me përshkrimin e dokumenteve të krijuara nga krijuesi dhe/ose nga burimet tjera të informatave për to ose të burimeve të krijuesve. Kapitulli 6 gjithashtu përfshin edhe modelet e të dhënave të cilat i shpjegojnë marrëdhëniet/lidhjet ndërmjet dokumenteve të normuara
- 4.6 Shtojca A, bënë krahasime (*mapping*) të elementeve të përshkruara ndërmjet botimit të parë dhe të tanishëm. Shtojca B, ofron shembuj të shumtë të dokumenteve të normuara arkivore, të përpiluara në harmoni me këtë standard.
- 4.7 Të gjitha elementet të përfshira me këto rregulla janë në dispozicion për shfrytëzim, por qenësore janë këta katër elemente:
- Lloji i entitetit (elementi 5.1.1);
  - Forma(t) e normuar të emrit(ave)/titujve (elementi 5.1.2);
  - Datat e veprimit (elementi 5.2.1);
  - Shenja e dokumentit të normuar (elementi 5.4.1).
- 4.8 Natyra e entitetit i cili përshkruhet dhe kërkesat e sistemit ose rrjetit të caktuar në kuadër të të cilit përpiluesi i dokumentit të normuar arkivor punon, përcakton se cili prej elementeve të zgjedhura të përshkrimit janë shfrytëzuar në dokumentin e caktuar të normuar dhe se ato elementet do të paraqiten në formën tekstuale dhe/ose strukturale.
- 4.9 Shumë prej elementeve të përshkruara në dokumentin e normuar të harmonizuar me ISAAR (CPF) do të shfrytëzohen si pikëqasje. Rregullat dhe dispozitat për standardizim të pikëqasjeve mund të zhvillohen në nivel nacional ose vetanak për çdo gjuhë. Fjalorët dhe dispozitat për përdorim në përpilim ose në zgjedhje të përmbajtjes së të dhënave për këto elemente, gjithashtu mund të zhvillohen në nivel nacional ose vetanak për çdo gjuhë.
- Për zhvillim dhe mirëmbajtje të fjalorëve të kontrolluar shfrytëzohen këto ISO standarde: ISO 5963 Dokumentacioni – Metodat për studimin e dokumenteve, përcaktimin e përmbajtjes së tyre dhe zgjedhjen e fjalëve për indeksim, ISO 2788 Dokumentacioni – Udhëzimet për

përpilimin dhe zhvillimin e tezausit njëgjuhësor, ISO 5964 Dokumentacioni – Udhëzimet për përpilimin dhe zhvillimin e tezausit shumëgjuhësor dhe ISO 999 Informacioni dhe dokumentacioni – Udhëzimet për përmbajtje, organizim dhe prezantim të indekseve. Në theksimin e burimit të shtypit në cilin do prej elementeve të përshkrimit, iu propozohet institucioneve versioni i fundit i ISO 690 Dokumentacioni – Udhëzimet bibliografike – Përmbajtja, forma dhe struktura.

- 4.10. Shembujt e dhënë nëpërmjet të këtij standardi nuk janë obligativ, por vetëm shpjegues. Ato parasëgjithash pasqyrojnë dispozitat e rregullave të cilat janë prezantuar dhe nuk kanë për qëllim që ti zgjërojnë. Shembujt dhe format në të cilat janë prezantuar nuk duhet të merren si instrukcione. Për shpjegimin e konteksteve, çdo shembull është përcjell e theksuar në kurziv të titullit të institucionit, i cili e ka përpiluar shembullin. Shpjegimet e mëtejme, gjithashtu në kurziv mund të shkoj me fjalën Vërejtje. Nuk duhet përzirë theksimin e burimeve të shembujve dhe cilën do vërejtje me vet shembullin.
- 4.11 Ky standard duhet të shfrytëzohet së bashku me botimin e dytë të *Standardit të përgjithshëm për përshkrimin e normuar të lëndës arkivore (ISAD (G))* dhe me standardet e tjera të përshkruara. Kur këto standarde shfrytëzohen në kontekstin e sistemit ose rrjetit të përshkrimit arkivor, dokumentet e normura do të ndërlidhet me përshkrimin e lëndës arkivore dhe anasjelltas. Shih: Kapitullin 6, Udhëzimet se si mund të krijohen këto lidheje (linqe). Përshkrimi i lëndës arkivore dhe dokumenteve mund të ndërlidhen me dokumentet arkivore të normuara në elementet Emri/titulli i krijuesit (3.2.1) dhe në elemente të historikut të krijuesit/biografisë (3.2.2) në kuadër të përshkrimeve në pajtim me standardin ISAD (G).
- 4.12 Ky standard duhet të shfrytëzohet së bashku me standardet dhe dispozitat kombëtare. Për shembull, arkivistën mund të përdorin standardet kombëtare kur vendosin se cilat elemente mundën, dhe se cilat nuk mundën të përsëriten. Në shumë vende, për sistemin e përshkrimit arkivor kërkohet vetëm një formë zyrtare e titullit/emrit të entitetit të caktuar, ndërsa në shtetet tjera është e lejuar krijimi i një ose më shumë formave zyrtare të titujve/emrave.
- 4.13 Ky standard vetëm me një pjesë të kushteve të cilat janë të nevojshme që të mbështesin këmbimin e informatave të normuara. Këmbimi i suksesshëm i amutomatizuar i informatave arkivore të normuara nëpërmjet të rrjetave të kompjuterit varët nga aprovimi i formateve të

përshatshme për komunikimin të institucioneve arkivore që marrin pjesë në atë komunikim. Konteksti i kodinuar arkivore - EAC (*Encoded Archival Context*) është një prej atyre formateve të komunikimit, i cili e mbështet ndryshimin e ISAAR (CPF) nëpërmjet të Internetit (World Wide Web -WWW). EAC është zhvilluar në formën definimit të tipeve të dokumenteve - DTDs-a (*Document Type Definitions*) në XML-u (*Extensible Markup Language*) dhe SGML (*Standard Generalized Markup Language*) gjuhëve.

## 5. ELEMENTET E DOKUMENTIT TË NORMUAR

### 5.1 LËMIA E IDENTITETIT

#### 5.1.1 Llojet e krijuesve (entiteteve)

*Qellimi:*

Të përcaktohet se krijuesi, i cili përshkruhet është person fizik, juridik ose familje.

*Rregulla:*

Të theksohet lloji i krijuesit (personi juridik, personi fizik dhe familja), i cili përshkruhet në këtë dokument të normuar.

***Shembuj:***

Institución

*Spain, Archivo General de Simancas*

***Vërejtje:*** Për dokumentin e normuar: *Consejo de Guerra.*

Ente

*Italy, Archivio di Stato di Firenze*

***Vërejtje:*** Për dokumentin e normuar: *Granducato di Toscana, principato mediceo, Auditore dei benefici ecclesiastici, Firenze (1545-1722) /*

*Granducato di Toscana, principatomediceo, Segretaria del Regio diritto, Firenze (1722-1737)*

Famille

*France, Centre historique des Archives nationales*

***Vërejtje:*** Për dokumentin e normuar: *Orléans, maison d'Entidade coletiva*

*Brazil, Arquivo Nacional*

***Vërejtje:*** Për dokumentin e normuar: *Arquivo Nacional (Brasil)*

Personi fizik

*Republika e Kosovës, Arkivi Shtetëror i Kosovës*

**Vërejtje:** Për dokumentin e normuar N.N.

Personi juridik

*Republika e Kosovës, Arkivi Shtetëror i Kosovës*

### **5.1.2 Forma(t) zyrtare të emrave/titujve**

*Qellimi:*

Të përpilohet pikë qasja normative, e cila në mënyrë të njëjtë do të identifikon personin juridik, fizik ose familjen.

*Rregulla:*

Të regjistrohen në formën e standardizuar emri/titulli i krijuesit, i cili përshkruhet në pajtim me të gjitha dispozitat relevante ndërkombëtare ose shfrytëzuesit juridik nga institucioni, i cili e ka përpuluar dokumentin e normuar. Të shfrytëzohet data, vendi, kompetencat, profesioni, llagapi ose percaktuesit tjerë të përshtatshëm për dallimin e emrin/titullit normativ nga krijuesit tjerë me emra/tituj të njëjtë. Në mënyrë të veçantë të theksohen elementet në rregullat dhe/ose dispozitat (5.4.3) të cilat janë tërësi e rregullave për këtë element.

*Shembuj:*

Granducato di Toscana, principato medico, Auditore dei benefici ecclesiastici, Firenze (1545-1722) Granducato di Toscana, principato medico, Segretaria del Regio diritto, Firenze (1722-1737)

*Italy, Archivio di Stato di Firenze*

**Vërejtje:** Titujt e normuar shumë-nivelesh për organin e njëjtë juridik.

Consejo de Guerra

*Spain, Archivo General de Simancas*

**Vërejtje:** Për shënimin e normuar: Consejo de Guerra.

Noel family, Earls of Gainsborough

*United Kingdom, The National Archives: Historical Manuscripts Commission*

York University Senior Common Rooms Inc.

*Canada, York University Archives*

Dampierre, Auguste-Henri-Marie Picot de (1756-1793; général)

*France, Archives départementales de l'Aube*

Shkolla e Lartë Pedagogjike në Prishtinë  
*Republika e Kosovës, Arkivi Shtetëror i Kosovës*

### 5.1.3 Format paralele të emrit/titullit

*Qellimi:*

Të theksohen format e ndryshme në të cilat dokumentet e normuara paraqiten në gjuhë ose shkrime të tjera.<sup>1</sup>

*Rregulla:*

Të shënohen percaktuesi(t) paralel(e) të emrave/titujve në pajtim me të gjitha dispozitat ose rregullat ndërkombëtare ose kombëtare të cilat i ka zbatuar institucion që e ka përpiluar dokumentin e normuar, duke përfshirë edhe nënelementet e domosdoshme dhe/ose përcaktuasit të cilët i kërkojnë ato dispozita ose rregulla. Thekso në elemente rregullat dhe/ose dispozitat (5.4.3) të cilat janë aplikuar.

***Shembuj:***

Maestre Racional de la Casa y Corte del Rey de Aragón Mestre Racional de la Casa i Cort del Rei d' Aragón.

*Spain, Archivo de la Corona Aragón*

***Vërejtje:*** Për shënimin e normuar: Maestre Racional de la Casa y Corte del

Rey de Aragón Awdurdod Cweicwlwm ac Asesu Cymru, 1994-1997

*United Kingdom, The National Archives: Historical Manuscripts Commission*

International Institute od human rights

Instituto internacional de derechos humanos

*France, Centre historique des Archives nationales*

***Vërejtje:*** Për shënimin e normuar: Institut international des droits de l'homme

Shkolla e Lartë Pedagogjike në Prishtinë

*Republika e Kosovës, Arkivi Shtetëror i Kosovës*

---

<sup>1</sup> Në rastet konkrete, posaçërisht në shtetet të cilat kanë më tepër se një gjuhë zyrtare, institucioni përgjegjës për dokumentin e normuar mund të përpilon një ose më shumë shënime të autorizuara, të cilët janë të njohur, si dhe ato të cilat kanë satatus të përafërt ose të njëjtë. Kjo situatë më së shpeshti paraqitet te emrat e personave juridikë, të cilët e kanë titullin më shumë se një gjuhë dhe/ose shkrime me statusin e emrit publik.

#### **5.1.4 Format e standardizuara të emrave/titujve në pajtim me rregullat tjera**

*Qellimi:*

Të theksohen format e standardizuara të emrave/titujve për personat juridik, personat fizik ose familjet të punuar sipas rregullave të ndryshme nga ato të cilat janë shfrytëzuar për përpilimin e dokumentit të normuar. Kjo mund të lehtëson këmbimin e dokumenteve të normuara ndërmjet bashkësive të ndryshme profesionale.

*Rregulla:*

Të shënohet forma e standardizuar e emrit të krijesit, i cili përshkruhet në pajtim me dispozitat ose rregullat tjera. Të theksohen rregullat dhe/ose emrin e përshtatshëm të institucionit në të cilin kjo formë e standardizuar e emrit/titullit është punuar.

*Shembuj:*

Toscana (Granducato), Segreteria del regio diritto (RICA = Regole italiane di catalogazione per autore)

Italy, Archivio di Stato di Firenze

*Vërejtje:* Forma e emrit të standardizuar Granducato di Toscana (1814-1859), principato mediceo, Auditore dei benefici exxlesiastici, Firenze (1722-1737), në pajtim me rregullat bibliotekare italiane të katalogut.

Mistry, Rohinton, 1952- çAACR 2<sup>2</sup>]

Canada, York University Archives

Shkolla e Lartë Pedagogjike në Prishtinë

Republika e Kosovës, Arkivi Shtetëror i Kosovës

#### **5.1.5 Format tjera të emrit/titullit**

*Qellimi:*

Të paraqitet çdo emër (emra) tjetër/titull(j) për personin juridik, personin fizik ose familjen, të cilët nuk janë shfrytëzuar tjetër vend, në lëminë e Identitetit.

*Rregulla:*

Të shenohen emrat/titujt tjerë të krijuesve të cilët mund të jenë të njohur, siç janë:

---

<sup>2</sup> Rregullat anglo-amerikane të katalogizimit.

- a) format tjera të emrit të njëjtë, p.sh. akronimet;
- b) emrat tjerë të personave juridik, p.sh. ndërrimi i titullit gjatë kohës kur kanë vepruar.<sup>3</sup>
- c) emra të tjerë të personave ose të familje, p.sh. ndërrimi i emrit gjatë jetës së tij, duke përfshirë edhe pseudonimet, mbiemrin e vajzërisë, etj.;
- d) emrat dhe titujt emëror, siç janë titujt fisnor ose titujt e nderit të cilët e kanë pasur individët ose familjet.

***Shembuj:***

Regio diritto Segreteria della reale giurisdizione

*Italy, Archivio di Stato di Firenze*

***Vërejtje:*** format tjera të emrit për shënimin e normuar: Granducato di Toscana, principato mediceo, Auditore dei benefici ecclesiastici, Firenze (1545-1722) / Granducato di Toscana, principato mediceo, Segreteria del Regio diritto, Firenze (1722-1737).

*Format tjera të udhëzimit – dokumentit të normuar*

Consejo de Guerra y Marina

Consejo de la Guerra

Supremo Consejo de Guerra

Real y Supremo Consejo de Guerra

***Shih*** Consejo de Guerra

*Spain, Archivo General de Simancas*

***Vërejtje:*** Për shënimin e normuar: Consejo de Guerra

Noel family, Barons Noel

Noel family, Barons Barham

Noel family, Viscounts Campden

Noel family, baronets, of Barham Court

*United Kingdom, The National Archives: Historical Manuscripts Commission*

Bordeaux, duc de

*France, Centre historique des Archives Nationales*

***Vërejtje:*** Për shënimin e normuar: Chambord, Henri, comte de

Arquivo Público do Império (1838-1890)

Archivo Público do Império

Arquivo Público Nacional (1890-1911)

---

<sup>3</sup> Në sistemet me dorë, format tjera të emrave/titujve me udhëzimin e kryqëzuar duhet të ndërlihdur me formën e normuar të emrit/titullit të shfrytëzuar SHIH.

Archivo Público Nacional  
Arquivo Nacional (1911- )  
Archivo Nacional  
*Brazil, Arquivo Nacional*  
**Vërejtje:** Për shënimin e normuar: *Arquivo Nacional (Brasil)*

Nuk kishte ndërrim të emrit  
*Republika e Kosovës, Arkivi Shtetëror i Kosovës*

### **5.1.6 Identifikatorët për personat juridik**

*Qëllimi:*

Të jepen çfardo shenje numerike ose alfa-numerike të cilat janë përdorur për identifikimin e personit juridik.

*Rregulla:*

Ku është e mundur të shenohet çdo emër zyrtar ose identifikator (p.sh. mumri amë i ndërmarrjes) për person juridik dhe të drejtohet në kompetencat juridike dhe skemën në bazë të cilës i është ndarë.

***Shembuj:***

Registered company 60096 (Companies House, England)  
*United Kingdom, The National Archives: Historical Manuscripts Commission*  
**Vërejtje:** Për person juridik *Cerain Iron Ore Company Ltd.*

04.374.067/0001-47 (Cadastro Nacional de Pessoas Juridicas – CNPJ)  
00320 (nº da unidade protocolizadora no Governo Federal)  
*Brazil, Arquivo Nacional*  
**Vërejtje:** Për shënimin e normuar: *Arquivo Nacional (Brasil)*

Numri amë:

Regjistri unik i institucioneve në Entin e Statistikës së Republikës së Kosovës.

*Republika e Kosovës, Arkivi Shtetëror i Kosovës*

## **5.2 LËMIA E PËRSHKRIMIT**

Qëllimi i kësaj lëmie është të përshkruhet historiku, roli, konteksti dhe veprimtaria e personit juridik, personit fizik ose familjes.

Koha e veprimit (5.2.1) duhet të shënohet si element i veçantë.



Informatat e theksuara në rregullat 5.2.3-5.2.8 mund të shenohet si të veçanta, elementet strukturale dhe/ose tekste narrative në elementin 5.2.2.

### 5.2.1 Koha e veprimit

*Qellimi:*

Të shënohet koha e veprimit të personit juridik, personit fizik ose të familjes.

*Rregulla:*

Të shenohet koha e veprimit të krijuesit i cili përshkruhet. Për personat juridik të përfshihet data e themelimit/konstituimit/të aktin juridik për fillimin e punës dhe të suprimimit. Për persona fizik përfshihet data ose përafërsisht datat e lindjes dhe të vdekjes ose, edhe pse këto data nuk janë të njohura, datat e veprimtarisë më intenzive të personit, lulëzimit (*floruit*<sup>4</sup>). Nëse janë shfrytëzuar sistemet paralele të datimit, ekvivalentët mund të shënohen në pajtim me dispozitat ose rregullat relevante. Të shënohen në elemente rregullat dhe/ose dispozitat (5.4.3) e sistemit(eve) të shfrytëzimit të datimit, p.sh. ISO 8601.

*Shembuj:*

1516 (probable)/1834-03-24.

*Spain, Archivo General de Simancas*

**Vërejtje:** Për shënimin e normuar: *Consejo de Guerra*

12th – 20th century

*United Kingdom, The National Archives: Historical Manuscripts Commission*

1573 – XX siècle

*France: Centre historique des Archives Nationales*

**Vërejtje:** Për shënimin e normuar: *Bérulle, famille*

1957-1998

*Republika e Kosovës, Arkivi Shtetëror i Kosovës*

---

<sup>4</sup> Fjala *floruit* do të thotë kur një person ishte gjallë ose aktiv (kjo shprehje përdoret kur data e lindjes ose e vdekjes nuk është e njohur).

## 5.2.2 Historiku

### *Qellimi:*

Të jepet historiku përmbledhës i personit juridik, personit fizik ose familjeve.

### *Rregulla:*

Të shënohet në formën narrative ose kronologjike ngjarjet kryesore nga jeta, veprimtaria, suksesi dhe/ose rolet e krijuesit, i cili përshkruhet. Këtu mund të përfshihet edhe informata për gjininë, kombësinë, familjen dhe përcaktimin fetar ose politik. Ku është e mundur, të vëhen datat si pjesë integrale e përshkrimit narativ.

### *Shembuj:*

El Consejo de Órdenes fue establecido a raíz de la incorporación a la Corona de los maestrazgos de las órdenes militares castellanas (Santiago, Calatrava y Alcántara) (1487-1495). Su fecha de creación no está determinada con exactitud, aunque algunos autores la sitúan sobre 1498. El Consejo de Órdenes, que en 1707 había asumido también la administración de Montesa, aunque no fue formalmente incluido en las reformas de la Administración del Antiguo Régimen de 1834 (RR.DD. de 24 de marzo de 1834, Decreto V), se transformó en un Nuevo organismo constitucional, el “Tribunal Especial de las Órdenes”.

*Spain, Archivo Histórico Nacional*

*Vërejtje: Për shënimin e normuar: Consejo de Órdenes*

